



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

RREGULLORE MBI TË DREJTAT DHE TRANSMETIMET AUDIO-VIZUALE

Prishtinë, 2023

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





Në bazë të nenit 23, alineja 1.23 dhe nenit 35 të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Bordi i FBK-së, në mbledhjen e mbajtur më 30.08.2023, miraton këtë:

RREGULLORE MBI TË DREJTAT DHE TRANSMETIMET AUDIO-VIZUALE

NENI 1 - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Me këtë rregullore përcaktohen modalitetet e shitjes, ri-shitjes dhe forma tjera të shpërndarjes të të drejtave audio-vizuale të garave të organizuara nga Federata e Basketbollit të Kosovës (në vijim: FBK), si dhe garave të FIBA-s apo organizatave tjera ndërkombëtare, ku FBK mban të drejta të transmetimit.

2. Sipas Statutit, FBK është pronare e të drejtave audio-vizuale të të gjitha garave që zhvillohen nën ombrellën e saj dhe mban të drejtën të realizojë të hyra nga këto të drejta. Federatat ka të drejtën e menaxhimit, shitjes, rishitjes në mënyrë vetanake ose në partneritet me ndonjë biznes tjetër, të këtyre të drejtave, me qëllim që mjetet e grumbulluara në këtë mënyrë të shfrytëzohen për avancimin e qëllimeve të përcaktuara me Statut. Mjetet e grumbulluara nga shitjet e tilla do të ndahen me klubet anëtare të Federatës, në bazë të formulave të përcaktuara me këtë Rregullore.

NENI 2 - TË DREJTAT AUDIO-VIZUALE

Për qëllime të kësaj Rregulloreje, të drejta audio-vizuale janë të drejtat për të gjitha incizimet tonike, xhirimet audio-vizuale, transmetimet direkt apo të mëvonshme në radio, televizion, internet, rrjete sociale, apo platforma tjera shpërndarëse të zhvillimeve në fushën e lojës në garat e FBK-së, që nga fillimi i ndeshjes/ngjarjes, deri në përfundimin e saj, ashtu siç definohet me Rregullat e Lojës së Basketbollit.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball supporters:



NENI 3 - TË HYRAT NGA TË DREJTAT AUDIO-VIZUALE

1. FBK është e obliguar që të hyrat nga të drejtat audio-vizuale ti përdorë për qëllime të përcaktuara në Statut dhe atë:

1.1 Të hyrat nga të drejtat audio-vizuale të Superligës do të shpërndahen sipas një formule, të cilën e përcakton Bordi i FBK-së para fillimit të sezonit, dhe informon klubet e Superligës. Formula në fjalë, varësisht nga çmimi i shitjes të të drejtave audio-vizuale, duhet të përcaktojë se mbi 50% e të hyrave të përgjithshme shpërndahen për anëtarët e Superligës dhe duhet të përmbajë:

- i. Fondin e pjesëmarrjes** - një shumë e caktuar nga Bordi, që është e barabartë për të gjitha ekipet pjesëmarrëse në Superligë dhe që u shpërndahet ekipeve.
- ii. Fondin e shpërblimeve** - një shumë e caktuar nga Bordi, varësisht nga lartësia e shumës së shitjes së të drejtave me të cilën shpërblehen klubet për sukses në sezonin garues.
- iii.** Të hyrat nga të drejtat audio-vizuale të ekipeve kombëtare, përveç nëse nuk precizohet ndryshe nga FIBA, do të përdoren në programet e kampeve/përgatitjeve dhe garave/ndeshjeve të ekipeve ndërkombëtare.
- iv.** Të hyrat tjera do të përdoren për programet për masivizim të basketbollit.

NENI 4 - TË DREJTAT TELEVIZIVE

1. Të drejtat televizive përfshijnë xhirimin e pjesëshëm ose të plotë, transmetimin e pjesëshëm ose të plotë, direkt ose jo-direkt të ndeshjeve nën ombrellën e FBK-së.

2. Kompanitë televizive që kanë qasje në ndeshjet e FBK-së kategorizohen si në vijim:

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





1.1. Bartës i të drejtave televizive - kompania që realizon transmetime direkte të ndeshjeve dhe mban të drejtat për reprizim, përpunim dhe arkivim të transmetimeve dhe pamjeve, si rezultat i marrëveshjes me FBK-në. Bartësi i të drejtave televizive është partneri medial i FBK-së dhe obligimet ose të drejtat shtesë, mund të precizohen në marrëveshje midis palëve të këtyre të drejtave.

2.1. Jo bartës i të drejtave televizive - kompania që realizon xhirim të pjesshëm ose të plotë të ndeshjes, pa të drejtë të transmetimit direkt dhe mban të drejtë për reprizim, përpunim dhe arkivim të pamjeve, si rezultat i marrëveshjes me FBK-në.

NENI 5 - RADHITJA E TRANSMETIMEVE DHE REKLAMAT

1. Radhitja e transmetimeve direkte televizive të ndeshjeve përcaktohet nga FBK në marrëveshje me bartësin e të drejtave televizive, pas hedhjes së shortit për edicionin garues përkatës dhe para fillimit të edicionit.

2. Bartësi i të drejtave televizive është i obliguar që së paku dy herë gjatë një sezoni garues (një herë në pjesën vjeshtore dhe një herë në pjesën pranverore) të realizojë transmetim të ndeshjeve të secilit ekip të ligës përkatëse si vendës.

3. Hapësira reklamuese televizive ku përfshihen promet, reklamat para, gjatë dhe pas ndeshjeve është e ndarë sipas formulës në vijim:

- 1.1.** FBK-së i takojnë 25% të hapësirës reklamuese;
- 2.1.** Klubit vendës i takojnë 50% të hapësirës reklamuese;
- 3.1.** Klubit mysafir i takojnë 25% të hapësirës reklamuese.

NENI 6 - TË DREJTAT TJERA

1. Të drejta të transmetimit të ndeshjeve në radio, internet, rrjete sociale, apo platforma tjera shpërndarëse, varen nga marrëveshja e FBK-së me bartësin e të drejtave televizive.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





2. FBK obligohet që të mbrojë ekskluzivitetin dhe përparësinë e bartësit të të drejtave televizive dhe vetëm pasi të sigurohet se ekskluziviteti dhe përparësia janë respektuar, mund të bëjë aranzhime për shitjen, ri-shitjen apo çfarëdo shpërndarje të të drejtave audio-vizuale në platforma tjera.

3. FBK mban të drejtën që të shpërndajë materiale nga garat e veta, në platformat e veta zyrtare (ueb-faqen zyrtare, profilin në Facebook dhe Twitter dhe kanalën në Youtube ose ndonjë platformë të ngjashme).

NENI 7 - IDENTITET KORPORATIV DHE SIMBOLET E FBK-SË

1. Transmetimet direkte televizive realizohen duke përdorur të njëjtin shabllon specifik të grafikave, siglave, paralajmërimeve dhe promote, dizajnin e së cilave e bën FBK ose bartësi i të drejtave, por që FBK e miraton për transmetim.

2. Klubet janë të obliguara që ti përmbahen kërkesave të FBK-së dhe bartësit të të drejtave televizive duke plotësuar në afatet e dhëna, kërkesat për:

1.1. Caktim të një personi përgjegjës për komunikim me FBK dhe bartësin e të drejtave për çështje të televizionit, transmetimeve dhe akreditimeve;

2.1. Sigurim të kushteve optimale për punë, për ekipin që transmeton ndeshjen dhe gazetarët e akredituar, përfshirë hapësirën e majftueshme, qasjen në internet dhe shpërndarjen në kopje të majftueshme të statistikave të ndeshjeve;

3.1. Dizajnim, prodhim dhe dërgim brenda afateve të fotografive të kualitetit të lartë të lojtarëve dhe ekipit, logos dhe simboleve ose ngjyrave identifikuese në formate grafike, sipas kërkesave të bartësit të të drejtave televizive.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

3. Shkelja e dispozitave të këtij neni do të konsiderohet si shkelje ndaj marketingut të ligës dhe do të sanksionohet sipas Propozicioneve të Garave.

NENI 8 - DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

1. Para fillimit të çdo edicioni garues, Bordi i FBK-së merr vendim për ndarjen e të hyrave nga shitja e të drejtave televizive mes të gjithë tetë anëtarëve të Superligës. Disbursimi i mjeteve nga FBK tek anëtarët e Superligës do të realizohet brenda 30 ditësh nga data e pranimit të tyre në xhirollogarinë e FBK-së.

2. Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj nga Bordi i FBK-së.

Kryetari
Arben **FETAHU**



Federata e Basketbollit të Kosovës

Prishtinë, 30.08.2023

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Automotive Sponsor: Youth Basketball supporters:

